

TË DHËNAT TEKNIKE

Lloji: Bojë epokside për dyshe me baze uji
Komponent: 2 komponentë-A (Boja epokside) B (agjent ngurtësues)
Ngjyra: E Bardhë ose e pigmentuar
Raporti i përzierjes: 4 kg (Komponenti A) ; 1 kg (komponenti B); (4:1)
Hollimi: Produkti mund të hollohet me uje deri ne 10% te peshes totale te perzierjes.
Koha e tharjes: 4-6 orë (në 20°C dhe 65% lagështi relative) ne prekje per doren e pare.
Viskoziteti: 70-90 KU (në 25°C)
Pesha Specifike: 1,25 ± 0,05 g/cm ³
Hapja: 6-7 m ² /kg (A+B+10% uje) një shtresë (në varësi të suportit)
pH: 8-9
Gloss (60°): 30-40 GU
Rezistenca në ngjitje: ≥ 2,0 N/mm ² (sipas ISO 4624)
Pershkueshmeria nga avujt e ujit: SD ≤ 5 m (EN ISO 7783)
Paketimi: 5 KG, (4 KG komp. A, 1 KG komp. B).
Rezistenca në abrazion: ca-35mg (ASTM D 4060).
Rezistenca ndaj kimikateve: Rezistence të lartë ndaj lëndëve kimike dhe mbetjeve industriale.
Rezistencë ndaj goditjeve dhe gërvishtjeve: Shumë e lartë.
Temperatura minimale e aplikimit: +10°C.
Temperatura maksimale e aplikimit: +30°C.

PINTOCOLOR®
TUTTI I MIEI COLORI



Dëshironi të dini më shumë mbi produktet tona ?
Autostrada Tiranë - Durrës, Km 5.
www.dekoll.al |
 +355 69 606 6656 |
 info@dekoll.al



PËRSHKRIMI

EPOX-PRO 2K është një bojë epokside përdysheme, me bazë uji, 2-komponentëshe, me një formulim të avancuar për mbulimin dhe mbrojtjen e dyshemeve industriale dhe komerciale. Ka një perfundim estetik, të pastër dhe rezistent ndaj larjeve të shpeshta. EPOX-PRO 2K vjen në ngjyre të bardhe ose të pigmentuar. EPOX-PRO 2K ofron një shtresë të qëndrueshme, të fortë, të pastër dhe miqësore me ambientin duke mbrojtur sipërfaqet kundër dëmtimeve mekanike, kimike dhe ndikimeve të tjera mjedisore. Ka një rezistencë të lartë ndaj solventeve alifatike, naftes, vajerave minerale, benzines apo detergjenteve. Rezistencë e lartë mekanike ndaj gervishtjeve, dëmtimeve dhe abrazionit.

PËRGATITJA E SUPORTIT

Sigurohuni që sipërfaqja të jetë e pastër, e thatë dhe pa pluhur, yndyrë ose mbetje të tjera që mund të ndikojnë në ngjytjen e bojës. Nëse suporti është shumë i lëmuar sugjerohet që të zmerilohet me leter zmerile dhe me pas të pastrohet nga pluhurat e krijuar, në mënyrë që të krijohet një ngjytje sa më e mirë e bojës me sipërfaqen që do aplikohet. Nëse është e nevojshme, pastroni sipërfaqen me një pastrues të përshtatshëm (tretësire acide 10%). Pastrohet me pas sipërfaqja mirë me ujë për të eliminuar mbetjet e tretësirës acide dhe lihet që të thahet plotësisht. Nëse ka defekte të mëdha në dysheme, duhet të bëhet riparimi i tyre përpara aplikimit të bojës.

PËRGATITJA E PRODUKUT

Shtoni komponentin B në komponentin A në raportin e dhënë dhe perzieni mirë tretësirën me një mikser me xhiro të uletë për rreth 5 minuta që të arrihet një masë homogjene. Pas perzierjes lerëni tretësirën në qetësi për 5 minuta në mënyrë që të sigurohemi që ka nisur reaksioni i induksionit. Pas kohës së pritjes bëhet hollimi me ujë i perzierjes, deri në 10%. Produkti është me pas i gatshëm për aplikim.

APLIKIMI

Përdorni një furçe, rrul ose spatul për aplikimin e bojës. Përpara aplikimit të bojës bëni astarimin e sipërfaqes me një dorë EPOX-PRIMER 2K sipas udhëzuesit të produktit. Produkti duhet të aplikohet brenda 60 min, mos provoni të holloni produktin në mënyrë për ta bërë perseri të aplikueshem pas kësaj kohe. Sigurohuni gjithmone që dora e parë e bojës së aplikuar të jetë e thatë plotësisht kur të aplikohet dora e dytë. Sipërfaqja e dyshemesë duhet të jetë e pastër dhe e thatë para aplikimit. Për të arritur mbulimin maksimal, mund të aplikoni disa shtresa të holla, duke pritur tharjen e plote ndërmjet secilës shtresë.

